



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
*Komisioni Qendror i Zgjedhjeve*  
*Centralna Izborna Komisija*  
*Central Election Commission*



Prishtinë/Priština, rr./ul. Migjeni p.n/b.b; tel. +381 (0) 38 211 337; kqz.sekretariati@kqz-ks.org; www.kqz-ks.org

## **Komunikatë**

**30.07.2013**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, mbajti mbledhjen e 39-të në të cilën, diskutoi çështjet e brendshme organizative, si dhe specifikat e ndryshme të organizimit të Zgjedhjeve Lokale 2013. Kryeshefi SKQZ, Enis Halimi, ndër të tjera, e informoi KQZ-në lidhur me përgatitjet që po bëhen për sigurimin e hapësirës për vendosjen e stafit jopermanent që do të angazhohet për këto zgjedhje. Ndërsa, Këshilli për Personel, e informoi KQZ-në për dy konkurset e shpallura: për atë të Zëdhënësit të KQZ-së, dhe atë për të Zëvendëskryeshefit të SKQZ-së. Kryesuesi i këtij këshilli, Florian Dushi, i rekomandoi KQZ-së që t'i themeloj dy panele për të dy konkurset, ose edhe vetëm një panel. Në fund, KQZ vendosi që të formohen dy panele për procedimin e këtyre konkurseve. Kryesuesi i KP-së, e informoi KQZ-në edhe për konkursin e stafit jo permanent. Ai tha se, janë 1852 aplikacione nga konkursi I shpallur, brenda afatit të paraparë. Do të formohen komisionet vlerësuese nga departamentet përkatëse për pozitat përkatëse, dhe do të fillohet sa më shpjetë për procesimin e konkursit. KQZ, kërkoi nga Sekretariati që lidhur me pozitat jo peramante, të formohen panelet në përbërje nga zyrtarët e departamenteve përkatëse për secilën pozitë.

Gjithashtu, KQZ u informua edhe për shqyrtimin lidhur me detyrat dhe përgjegjësitë e anëtarëve të KKZ-ve, të cilët kanë funksionuar jashtë kriterëve dhe përgjegjësisë së tyre. Në kontratë, ata duhet t'i kenë të përshkruara detyrat dhe përgjegjësitë në raport me ligjin, dhe që të raportojnë sipas pozitive, dhe sipas detyrave të tyre. KQZ, u pajtua që përshkrimi dhe miratimi i detyrave dhe i përgjegjësisë të anëtarëve të KKZ-ve, të ndryshohet dhe të prezantohet për miratim në mbledhjen radhës.

Këshilli për Operacione Zgjedhore, e informoi KQZ-në lidhur me shqyrtimin dhe miratimi i Planit Operativ të Sigurisë për Zgjedhjet Lokale 2013. Alban Krasniqi, kryesuesi i këtij këshilli, tha se, e kemi kthyer planin me kërkesën edhe të koordinatorit të terrenit në mënyrë që plani, të shikohet edhe nga Policia e Kosovës. Kemi menduar që kjo është e rëndësishme! Përmbajtja nuk është ndryshuar, veçse ndonjë datë. Në fund të debatit, KQZ, e miratoi Planin Operativ të Sigurisë për zgjedhjet 2013, dhe u pajtua që gjatë bashkëpunimit me Policinë e Kosovës (PK), të organizohet edhe një trajnim.

Kryesuesi i KOZ-i, Alban Krasniqi, e informoi KQZ-në edhe për emërimin e anëtarëve të KKZ-ve të Subjektit Politik "SLS", për komunat: Leposaviq, Zubin Potok, Zveçan dhe Mitrovicë e veriut. Sipas kriterëve të parapara, është bërë shikimi, si dhe verifikimi i këtyre të nominuarve. Anëtarët e KQZ-së, miratuan katër (4) anëtarët e KKZ-ve për këto komuna.

Në vazhdim të mbledhjes, u shqyrtuan edhe specifikat teknike dhe të dizajnit për Distinktivat e KVV-ve. Kryesuesi i KOZ-it, tha se, janë bërë fare pak ndryshime, dhe janë zgjedhur dy versione. KQZ, do

të vendos për njërin version. Pas shqyrtimit, KQZ i miratoi specifikat dhe dizajnin e distinktivit për KVV-të për Zgjedhjet Lokale 2013.

KQZ, shqyrtoi dhe vendosi edhe për qendrat e reja të votimit. Ai tha se, në dy mbledhje radhazi, janë shqyrtuar rekomandimet e ardhura nga SKQZ. Në fund, u ra dakord që të themelohen edhe pesëdhjetë e tetë (58) Qendra të Reja të Votimit.

**Komisioni Qendror i Zgjedhjeve**